



KODI I ETIKES

PERMBAJTJA

VLERAT TONA	3
Përgjegjësia jonë sociale dhe mjedisore	4
Misioni ynë	5
Parimet dhe vlerat e referimit	5
PARIMET E SJELLJES NE MARREDHENIE ME GRUPET E INTERESIT	7
Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me të gjitha grupet e interesit	8
Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me klientët	8
Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me aksionerët	131
Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me punonjësit	153
Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me furnitorët	186
Parimet e sjelljes ndaj mjedisit	19
Parimet e sjelljes në lidhje me komunitetin	18
ZBATIMI DHE KONTROLLI	24
Mekanizmat për zbatim, shpërndarjen e brendshme dhe qeverisjen	25

VLERAT TONA

Përgjegjësia jonë sociale dhe mjedisore

Në ditët e sotme kompanitë duhet të marrin përgjegjësi më të mëdha, që nuk kufizohen vetëm tek efektet ekonomike të aktiviteteve të tyre. Në fakt, funksionet e tyre janë gjithnjë e më të gjera dhe më të strukturuar.

Për t'ju përgjigjur në mënyrë efikase një game gjithnjë e në rritje të nevojave, kompanitë duhet të demonstrojnë vetëdijen e tyre të plotë në lidhje me faktin se ciklet e tyre të prodhimit dhe produktet e hedhura në treg kanë ndikim jo vetëm tek konsumatorët, të cilët duhet padyshim të plotësojnë një kërkesë të përshtatshme ekonomike, por edhe tek qytetarët e shoqërisë ku këto kompani ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Këto interesa përfshijnë ruajtjen e mjedisit tonë natyror, shëndetin, punën, të ardhmen, mirëqenien e të gjithë komunitetit dhe mbrojtjen e sistemit të marrëdhënieve shoqërore.

Numri i grupeve të interesit me të cilat kompania duhet të ndërveprojë do të rritet së bashku dhe paralelisht me gamën e interesave të cilat preken nga aktivitetet e kompanisë.

Të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të lidhur me biznesin e kompanisë për shkak të kontributit, të ndryshëm dhe të veçantë, që japin në përmbushjen e misionit të kompanisë, ose për shkak se mirëqenia e tyre ndikohet ndjeshëm - qoftë pozitivisht ose negativisht - nga ky aktivitet biznesi, duke ndarë kështu në një mënyrë apo një tjetër një pjesë të rrezikut të kompanisë, duhet të njihen si grupe interesi.

Këto palë të interesuara janë klientët, aksionerët, punonjësit, furnitorët dhe madje vetë mjedisin - ose më mirë të drejtat që brezat e ardhshëm kanë në këtë drejtim - dhe, së fundmi shoqëria në tërësi.

Për më tepër, kompanitë tashmë ushtrojnë aktivitetin e tyre gjithnjë e më shpesh në zona të ndryshme gjeografike me rregulla të ndryshme. Kjo është arsyeja pse vetëdisiplina është e rëndësishme: duke respektuar rregullat në fuqi, vendosen standarde më të larta të cilat kompania synon t'i respektojë në fushat ku ajo ushtron aktivitetin.

Grupi Intesa Sanpaolo ka vendosur që të hartojë Kodin e tij të Etikës, të strukturuar si "Karta e vërtetë e Marrëdhënieve" midis Bankës dhe të gjitha grupeve të saj të interesit. Në të përshkruhen vlerat në të cilat Intesa Sanpaolo beson dhe për të cilat është angazhuar, duke përshkruar parimet e sjelljes që burojnë nga konteksti i marrëdhënies me secilin grup interesi dhe, rrjedhimisht, duke ngritur standardet që secili person brenda kompanisë duhet të ketë në mënyrë që të meritojë besimin e të gjithë grupeve të interesit.

Vlerat që përshkruhen në këtë Kod janë shprehja e kulturave dhe prejardhjes së kompanisë që përfaqëson Intesa Sanpaolo: nga njëra anë "lentja" përmes së cilës mbikëqyr dhe interpreton situata të ndryshme, dhe nga ana tjetër, një objektiv për tu arritur, fundi i një rruge që do të karakterizojë aktivitetin tonë gjatë viteve të ardhshme.

Ky Kod, si mjet i qeverisjes së korporatës, është pjesë e një vizioni më të gjerë të përgjegjësisë tonë sociale dhe mjedisore, dhe vendos në qendër marrëdhëniet tona me të gjitha grupet e interesit. Dialogu konstruktiv me ta nxit dhe zhvillon një proces që gjeneron përmirësim të vazhdueshëm, nëpërmjet dëgjimit të kërkesave dhe përfshirjes së tyre në strategjinë e kompanisë.

Nëpërmjet publikimit të Raportit vjetor të Qëndrueshmërisë, së bashku me raportimin transparent të asaj që kemi arritur, do të evidentojmë kërkesat që rezultojnë nga dialogu ynë i vazhdueshëm me grupet e interesit dhe do të ndërtojmë qëllimet dhe objektivat tona. Verifikimi i vazhdueshëm i aftësive tona për të ofruar përgjigje grupeve të interesit do të na ndihmojë të mbajmë gjallë vlerat që përcaktohen në këtë Kod dhe përfshirjen e tyre në jetën e përditshme të kompanisë.

Misioni ynë

Ne punojmë që t'i ofrojmë klientëve tanë shërbime bankare dhe financiare cilësore duke mbështetur zhvillimin në të gjitha vendet ku ne ushtrojmë aktivitetin tonë.

Të ndërgjegjshëm për vlerat e aktiviteteve tona në Itali dhe jashtë saj, ne promovojmë një zhvillim dhe rritje që ka në fokus rezultatet e qëndrueshme dhe krijimin e një procesi të bazuar mbi besimin që buron nga kënaqësia e klientëve dhe aksionerëve tanë, një ndjenjë përkatësie të punonjësve si dhe monitorim të vazhdueshëm të nevojave të komunitetit dhe të vendit ku punojmë.

Ne konkurrojmë ndershmërisht në treg dhe jemi gati për të bashkëpunuar me subjektet e tjera ekonomike, private dhe publike, sa herë që është i nevojshëm, për të përforcuar kapacitetin e përgjithshëm për rritjen dhe zhvillimin e ekonomive të vendeve ku ushtrojmë aktivitetin tonë.

Marrim përsipër përgjegjësinë e menaxhimit të kursimeve, angazhohemi që të ofrojmë kredi dhe mjete financiare të gjithë qytetarëve, si dhe mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit sipërmarrës, të ndërgjegjshëm që vendimet tona kanë një ndikim të madh, direkte dhe indirekt, më mjedisin natyror dhe në komunitet. Ne dëshirojmë të kontribuojmë për mirëqenien e të dyjave (jo vetëm materiale) nëpërmjet mbështetjes dhe realizimit të iniciativave kulturore dhe projekteve për të mirën e përbashkët.

Vlerat dhe parimet bazë

Strategjia jonë e rritjes synon krijimin e vlerave solide dhe të qëndrueshme nën profilin ekonomik dhe financiar, social dhe mjedisor, të ndërtuar mbi besimin e të gjitha grupeve të interesit dhe bazuar në vlerat e mëposhtme:

Integritet

Ne përmbushim objektivat tona me ndershmëri, korrektësi dhe përgjegjshmëri, duke respektuar rregullat, etikën profesionale dhe në frymën e marrëveshjeve që nënshkruajmë.

Përsosmëri

Ne i vendosim vetes qëllimin e përmirësimit të vazhdueshëm, largpamësisë, parashikimit të sfidave të së nesërme dhe kultivimit të krijueshmërisë të prirur drejt risive dhe inovacionit, duke vlerësuar dhe shpërblyer meritat.

Transparencë

Ne jemi të angazhuar që transparenca të jetë baza e veprimeve tona, komunikimeve, reklamave dhe kontratave tona duke u ofruar të gjithë grupeve tona të interesit mundësinë për të bërë zgjedhje dhe marrë vendime të pavarura dhe të vetëdijshme.

Respekt për cilësi të veçanta

Është qëllimi ynë të bashkërendojmë aktivitetet dhe operacionet në shkallë të gjerë me veçoritë specifike të tregut lokal, të jemi një bankë largpamëse me vizion të gjerë duke mos humbur nga vëmendja individin.

Barazi

Ne jemi të angazhuar që të eliminojmë të gjitha format e diskriminimit në sjelljen tonë dhe të respektojmë diferencat gjinore, të moshës, racës, përkatësisë fetare, politike ose sindikale, identitetit dhe orientimit seksual, gjuhës ose aftësive ndryshe.

Vlera e individit

Vlera e çdo personi udhëheq dhe drejton mënyrën tonë të veprimit: dëgjimi dhe dialogu janë mjetet që ne përdorim për të përmirësuar marrëdhëniet me partnerët tanë.

Përgjegjësi në përdorimin e burimeve

Ne kemi si qëllim të përdorim në mënyrë të kujdesshme të gjitha burimet tona, duke promovuar sjelljet që mundësojnë optimizimin e burimeve dhe evitimin e shpenzimeve të tepërta, duke privilegjuar zgjedhjet që janë të qëndrueshme në kohë.

**PARIMET E SJELLJES NE MARREDHENIE ME
GRUPET E INTERESIT**

Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me të gjitha grupet e interesit

Ky kod paraqet vlerat e Grupit Intesa Sanpaolo dhe synon t'i drejtojë sjelljet individuale në përputhje me këto vlera, duke ditur se njohja e faktorëve social dhe mjedisor kontribuon në minimizimin e ekspozimit ndaj rreziqeve të kredisë dhe përputhshmërisë rregullative si dhe forcon reputacionin e kompanisë.

Në linjë me parimet e Global Compact që promovon Organizata e Kombeve të Bashkuara, të cilat në i respektojmë, jemi të angazhuar:

- të mbështesim dhe mbrojmë të drejtat e njeriut sipas parimeve të Deklaratës Universale të vitit 1948;
- të njohim dhe pranojmë parimet e vendosura në konventën themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe veçanërisht lirinë e asocimit dhe të drejtën për bisedim kolektiv, eliminimi i çdo forme të punës së detyruar apo të detyrueshme dhe zhdukja efektive e punës së fëmijëve dhe eliminimi i diskriminimit në punësim dhe profesion.
- të kontribuojmë në luftën kundër korrupsionit, duke ndjekur udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe parimet kundër korrupsionit të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara në vitin 2003, gjithashtu nëpërmjet një qëndrimi me tolerancë zero ndaj çdo episodi korrupsioni.

Gjithashtu ne,

- kërkojnë transparencën më të madhe në sjelljet e kompanisë dhe inkurajojnë eliminimin e çdo elementi që mund të rezultojë në situata të konfliktit të interesit, edhe nëse ato janë vetëm potenciale.

Grupi Intesa Sanpaolo merr përsipër të promovojë, në të gjitha kompanitë e Grupit - edhe për qëllimet e aderimit të tyre - dhe në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin, sjelljet që mbështeten mbi këto parime. Ne gjithashtu angazhohemi për përhapjen e vlerave dhe parimeve të këtij Kodi në kompanitë ku jemi aksioner në minorancë dhe në ndërmarrje të përbashkëta.

Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me klientët

Dëgjim dhe dialog

Ne besojmë që klienti duhet të jetë gjithmonë në qendër të vëmendjes tonë dhe vetëm nëpërmjet dialogut të vazhdueshëm mund të kuptojmë vërtetë pritshmëritë e tyre aktuale dhe të mbajmë marrëdhënie të shkëlqyera:

- për zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve të reja ne përdorim mjete të dialogimit sistematik për të kuptuar sugjerimet e klientëve dhe të

shoqatave të konsumatorëve që përfaqësojnë kategori të veçanta të konsumatorëve;

- nëpërmjet dialogut me klientët tanë, ne identifikojmë me saktësi profilin e tyre të riskut, një pikë fillimi kjo shumë e rëndësishme për ofrimin e konsulencës dhe produkteve financiare në koherencë me nevojat e tyre. Ne e kuptojmë që duke vepruar në këtë mënyrë luajmë një rol të rëndësishëm duke ndihmuar investitorët dhe duke ofruar shërbime për menaxhimin e kujdesshëm të kursimeve;
- ne i përgjigjemi menjëherë pyetjeve dhe ankesave, duke synuar një zgjidhje reale dhe joformale të mosmarrëveshjeve.

Transparencë

Ne besojmë që në marrëdhëniet jetëgjata të bazuar në besim, komunikimi u ofron klientëve mundësinë për të kuptuar karakteristikat dhe vlerën e të gjitha produkteve dhe shërbimeve që u ofrohen dhe/ose blejnë:

- ne thjeshtojmë produktet, hartojmë kontrata të thjeshta për tu kuptuar dhe minimizojmë keqkuptimet e mundshme dhe paqartësitë duke ofruar një informacion të plotë dhe të detajuar. Ne komunikojmë menjëherë çdo ndryshim në kontratat dhe kushtet e përcaktuara në to;
- ne përgatisim një komunikim të qartë në të gjitha kanalet e disponueshme, duke i dhënë vlerë kohës së klientit.

Barazi

Ne besojmë që shërbimet tona duhet të ofrohen për të gjithë:

- ne nuk diskriminojmë klientët tanë në bazë të kombësisë, besimit apo gjinisë së tyre.
- ne përgatisim ofertat tona në mënyrë që të gjitha shtresat sociale të gjejnë një përgjigje ndaj nevojave të tyre;
- ne zbatojmë një politike çmimesh në linjë me cilësinë e shërbimit të ofruar;
- ne mundësojmë që degët tona të jenë aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara duke eliminuar barrierat arkitektonike.

Aksesi në kredi dhe përfshirja financiare

Ne besojmë se zgjerimi i aksesit në kredi dhe ofrimi i shërbimeve bankare shtresave të dobëta të shoqërisë përbëjnë një pjesë themelore e përfshirjes

sociale, duke bërë të mundur që njerëzit të përmirësojnë gjendjen e tyre dhe të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre të qytetarisë.

Duke marrë në konsideratë parimet e kujdesit në vlerësimin e besueshmërisë së klientit, falë të cilave mbrojmë jo vetëm interesat tona por edhe ato të klientëve ne:

- përcaktojmë zonat e mundshme të ndërhyrjes dhe rrjedhimisht zgjerojmë gamën e ofertës tonë me produkte dhe shërbime që plotësojnë dhe përmbushin më mirë kërkesat e dinamikave sociale gjithmonë në zhvillim;
- mbështesim zhvillimin e sipërmarrjes së re në mbështetje të aktiviteteve që kanë potencial për të krijuar vlera ekonomike dhe sociale të pashprehura më parë;
- i kushtojmë vëmendje të veçantë ndërmarrjeve me orientim social dhe jo-fitimprurëse, dhe sektorit të tretë, duke pranuar se aktivitetet e tyre përfaqësojnë një faktor të rëndësishëm në kohezionin social dhe në promovimin e të drejtave civile.

Mbështetje ndaj zhvillimit të vendit

Ne besojmë që një bankë e madhe ka përgjegjësi të veçantë për të promovuar rritjen ekonomike dhe sociale në vendin ku ajo ushtron aktivitetin e saj bankar dhe financiar, si dhe duhet:

- të mbështes sipërmarrjet për zgjerimin e aktivitetit të tyre, përmirësimin e konkurrencës së tyre, dhe zhvillimin e biznesit jashtë kufijve të vendit;
- të mbështes sipërmarrjet që kanë projekte të vlefshme, edhe në momente të vështira, për realizimin dhe gjetjen e zgjidhjeve inovative në funksion të riorganizimit dhe promovimit të tyre në vijim;
- të mbështes sektorin publik dhe autoritetet lokale, deri në masën e arsyeshme të lejuar, sipas kriterëve të bashkëpunimit duke evituar ndërhyrjet dhe duke promovuar zgjidhje financiare që garantojnë ruajtjen e një ekuilibri afat-gjatë në lidhje me rritjen dhe modernizimin të cilat ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë në përgjithësi;
- të zbatojë standardet më të mira dhe udhëzimet e pranuar në nivel ndërkombëtar mbi vlerësimin e impakteve sociale dhe mjedisore (Deklarata e UNEP-it, Parimet Global Compact të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Parimet e Ekuatorit të cilat ne respektojmë dhe zbatojmë) në fushën e financimit të projekteve dhe veçanërisht për projektet infrastrukturore;

- të zhvillojë mekanizma të reja financiare afat-mesme në mbështetje të inovacionit dhe sipërmarrjes së subjekteve të cilat, megjithëse nuk kanë kapital të mjaftueshëm, kanë ide dhe projekte premtuese;
- të kapërcejë kufijtë e kredidhënies dhe pjesëmarrjes në kapitalin për riskun, duke mbështetur projekte me një potencial të lartë rritje dhe zhvillimi në sektorët e rinj.

Promovim i ekonomive lokale dhe lidhjes së fortë në Itali dhe jashtë saj

Ne besojmë se mbështetja efektive për të gjitha vendet ku ne ushtrojmë aktivitetin tonë, duke lidhur rezultatet ekonomike me respektin për vlerat themelore të komuniteteve lokale, mund të evidentojnë të gjithë potencialin gjitha potencialet e biznesit lokal, te përbërë nga ndërmarrjet e vogla dhe te mesme:

- ne vlerësojmë shumë marrëdhëniet me komunitetin lokal dhe qasja e afërt ndaj nevojave të tregut ku operojmë mbetet thelbësor. Për këtë arsye, ne përcaktojmë dhe krijojmë procese organizative dhe mjete të brendshme të cilat kanë në fokus thjeshtimin dhe zhvillimin e një oferte të përshtatshme, duke dashur të jemi banka e marrëdhënies dhe jo vetëm një rrjet shitjeje.
- ne studiojmë evoluimin dhe zhvillimin e sistemeve ekonomike lokale për të mbështetur ndërmarrjet në marrjen e vendimeve të tyre strategjike dhe për të orientojmë politikën e Grupit drejt mbështetjes së nevojave të veçanta financiare të subjekteve ekonomike që veprojnë në një zonë apo vend të caktuar;
- ne ofrojmë shërbimet tona jo vetëm si ofrues të kredisë apo kapitalit por edhe si partnerë për promovim dhe zhvillim;
- ne punojmë ngushtë me individët dhe komunitetet me synimin për të promovuar zhvillimin më të mirë të mundshëm dhe mbështetur progresin social dhe ekonomik, veçanërisht në fushat që kanë nevojë për rigjallërim ekonomik;
- ne promovojmë iniciativa me vlerë të lartë sociale, edhe në partneritet me operatorë lokal të specializuar në këto fusha;
- ne zhvillojmë përjasjen nëpërmjet kanaleve alternative në mbështetje të ofrimit të shërbimeve tona.

Investime të përgjegjshme sociale

Ne besojmë që vlerësimi i investimeve duhet t'i kushtojë gjithnjë e më shumë rendësi kritereve mjedisore, sociale, dhe të qeverisjes (ESG) me qëllim promovimin e një zhvillimi të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm. Ne u ofrojmë klientëve tanë mundësinë për të zgjedhur produkte të cilat administrohen sipas parimeve etike, sociale dhe mjedisore në funksion të përmirësimit të profilit të tyre risk/përfitim, dhe aktivizimit të procesit që përfshin sensibilizimin progresiv të vetë klientëve dhe angazhimin e ndërmarrjeve drejt sjelljeve të pranueshme të qëndrueshme:

Mbrojtje dhe siguri

Ne besojmë që mbrojtja dhe siguria e klientëve tanë, asetëve, informacionit konfidencial dhe të dhënave të tyre, nuk përfaqësojnë vetëm një detyrë primare, por edhe bazën e marrëdhënies së besimit që ne duam të ruajmë. Prandaj ne:

- kujdesemi për mbrojtjen e individëve, vlerave dhe të mirave materiale, si dhe të informacionit dhe proceseve të brendshme organizative në mënyrë që të ofrojmë një shërbim që përmbushë plotësisht kërkesat e besueshmërisë, vazhdimësisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit;
- garantojmë zbatimin e plotë të ligjit;
- respektojmë kriteret për transparencë të plotë në informimin e klientëve tanë mbi të drejtën e tyre të privatësisë dhe mënyrën e trajtimit të të dhënave të tyre personale.

Vlerësim i rrezikut social – mjedisor

Ne besojmë që vendimet tona për investimet dhe politikat e kreditimit duhet të vlerësojnë rreziqet sociale dhe mjedisore sipas parimit që një aktivitet që prodhon vlere ekonomike do të jetë i qëndrueshëm vetëm nëse nuk shkatërron njëkohësisht vlera sociale ose mjedisore; Prandaj ne:

- veprojmë në përputhje me protokollet kombëtare dhe ndërkombëtare për respektimin e standardeve sociale dhe mjedisore;
- përjashtojnë marrëdhëniet financiare, që mbështesin aktivitetet ekonomike të cilat kontribuojnë, edhe në mënyrë indirekte, në shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, që pengojnë zhvillimin njerëzor ose që dëmtojnë rëndë shëndetin e personave ose të mjedisit;
- promovojmë bashkëjetesën paqësore dhe evitojmë mbështetjen financiare ndaj aktiviteteve që e dëmtojnë atë.

Parimet e sjelljes ne marrëdhëniet me aksionerët

Grupi Intesa Sanpaolo ka miratuar sistemin e qeverisjes me një nivel, ku funksionet e drejtimit dhe kontrollit kryhen nga Këshilli Drejtues. Disa nga anëtarët e tij janë gjithashtu anëtarë të Komitetit të Kontrollit.

Gjatë implementimit të qeverisjes së re, ne kemi marrë në konsideratë udhëzimet e Kodin e Sjelljes të kompanive të listuara, të cilat janë promovuar nga Borsa Italiana S.p.A (Bursa Italiane), udhëzime që respektohen vullnetarisht nga Grupi Intesa Sanpaolo.

Grupi Intesa Sanpaolo zbaton parimet e qeverisjes së mirë në rregulloret operacionale të Organeve të Qeverisjes së Korporatës dhe në sjelljen e drejtorëve dhe drejtuesve.

Barazi

- ne veprojmë duke mbrojtur vlerën e kapitalit që aksionerët kanë investuar tek INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. dhe duke garantuar rritjen e qëndrueshme;
- ne sigurojmë barazi në informimin e aksionerëve dhe i kushtojmë vëmendje maksimale aksionerëve pa diskriminime ose preferenca;
- ne besojmë se Mbledhjet e Aksionerëve përfaqësojnë një mundësi të mirë për të vendosur një dialog të suksesshëm, në përputhje me të drejtën e informimit dhe rregulloret për informacionin sensitiv mbi çmimet. Në këtë drejtim, Banka inkurajon pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme në Mbledhjet e Aksionerëve dhe siguron që të drejtat e votimit të ushtrohen në mënyrë korrekte;
- Kryetari i Këshillit Drejtues drejton mbledhjet e aksionerëve dhe garanton të drejtat e të gjithë aksionerëve.

Transparencë ndaj tregut

Të gjitha komunikimet financiare të Grupit Intesa Sanpaolo, si edhe ato që paraqiten tek Autoritetet Mbikëqyrëse dhe Kontrollit, kombëtare dhe ndërkombëtare, bazohen në transparencë, tërësinë dhe afatet kohore të informacionit, si dhe në zbatim të plotë të ligjit dhe kodeve të miratuara për vetëqeverisjen:

- ne i garantojmë aksionerëve dhe komunitetit financiar në përgjithësi komunikim transparent dhe në kohë, me qëllimin për dhënien e informacionit të qartë, të plotë dhe të menjëhershëm në lidhje me zbatimin e strategjive dhe rezultateve që ka arritur Banka.

- Për të garantuar informimin e njëjtë të të gjithë aksionerëve dhe organizatave të tjera që impaktohen nga ecuria e grupit, informacioni vihet në dispozicion nëpërmjet disa kanale të ndryshme, përfshirë faqen zyrtare të internetit, ku midis të tjerave publikohen:
- raporti vjetor dhe raportet periodike;
 - raporti vjetor mbi qeverisjen e korporatës;
 - informimi i aksionerëve mbi kushtet dhe formalitetet e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të tyre, si p.sh. pjesëmarrja në mbledhjet e aksionerëve, arkëtimi i dividendëve, transaksionet e kapitalit etj.
 - njoftimet për shtyp dhe prezantimi në treg i rezultateve dhe strategjive të korporatës;
 - dokumentet kryesore të korporatës;
 - të dhëna që tregojnë ecurinë e letrave me vlerë në tregun e aksioneve dhe strukturën e aksionerëve;
 - vlerësimet e Bankës nga agjenci të specializuara.
- në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, në zhvillojmë vazhdimisht takime dhe konferenca, nëpërmjet telefonit ose internetit, me komunitetin financiar lokal dhe ndërkombëtar, për të përforcuar marrëdhëniet afatgjata dhe të vazhdueshme që kontribuojnë në krijimin e vlerave të qëndrueshme.

Politika shpërblimi për drejtuesit dhe punonjësit

Politika e shpërblimit që është miratuar për të gjithë punonjësit e Grupit, përfshirë dhe elementët e ndryshueshëm të pagës, bazohet në meritë, paanësi dhe qëndrueshmërinë e rezultateve. Udhëzimet e përdorura për të përcaktuar politikën e shpërblimit për drejtuesit bazohen në elemente objektive dhe parametra që vijnë si rezultat i vlerësimit të pozicioneve organizative, performancës dhe potencialit, dhe synojnë të formojnë një sistem të integruar për të mbështetur menaxhimin dhe zhvillimin profesional.

Transparenca është pjesë integrale e sistemeve të shpërblimit dhe sistemeve incentivuese për punonjësit në të gjitha nivelet, me qëllim rritjen e konkurrencës, tërheqjen dhe mbajtjen brenda grupit nivelin më të lartë të ekspertizës dhe profesionalizmit.

Në veçanti, sistemet incentivuese, në përputhje me dispozitat rregullatore, janë hartuar duke u bazuar në strategjitë afatgjata dhe brenda një kuadri rregullativ që synon kontrollin e duhur të rreziqeve të kompanisë të tashme dhe të ardhshme si edhe ruajtjen e një niveli të përshtatshëm likuiditeti dhe kapitalizimi.

Në parashikojmë forma shpërblimi në bazë të incentivave - të bazuara gjithashtu edhe në instrumente financiare dhe të lidhura me rezultatet e kompanisë - në përputhje me nivelin e rrezikut të marrë dhe të strukturuar në mënyrë të tillë që shmangin vendosjen e incentivave që nuk janë në përputhje me interesat

afatgjatë të Grupit. Sistemet tona të incentivave frymëzohen, ndër të tjera, edhe nga parimet e simetrisë, sipas të cilave shumica e stimujve të paguar lidhet ngushtë me rezultatet e arritura në nivel Grupi, Njësie Biznesi dhe në nivel individual dhe mund ulet ndjeshëm, madje deri në zero, nëse treguesit minimal që pasqyrojnë përfitueshmërinë e Grupit nuk arrihen, duke marrë parasysh gjithashtu rreziqet e marra dhe kapitalin e përdorur.

Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ne aplikojmë një kufi për shumën e parashikuar për tu dhënë në bazë të performancës dhe ecurisë në punë, në përputhje me dispozitat rregullative për këtë çështje.

Dokumentacioni mbi rolin dhe prerogativat e Organeve të Qeverisë në lidhje me përcaktimin e mekanizmave të shpërblimit dhe incentivave si dhe zbatimin e politikave të shpërblimit është i disponueshem në faqen zyrtare të internetit www.group.intesasanpaolo.com.

Parimet e sjelljes në marrëdhëniet me punonjësit

Respekt për individin

Ne besojmë që respektimi i personalitetit dhe dinjitetit të çdo punonjësi është thelbësor për zhvillimin e një mjedisi pune i cili karakterizohet nga besimi reciprok, ndershmëria dhe pasurohet nga kontributi i gjithsecilit. Rrjedhimisht, ne:

- zbatojmë procedura për rekrutimin dhe menaxhimin e punonjësve që bazohen në sjellje të drejta dhe koherente, të cilat ndalojnë favorizimin, abuzimin dhe diskriminimin sipas gjinisë, etnisë, besimit, bindjeve politike ose pjesëmarrjes në sindikata, orientimit seksual dhe identitetit, gjuhës, moshës ose aftësive të kufizuara;
- garantojmë mundësi të barabarta zhvillimi dhe rritjeje profesionale, përfshirje në programe trajnimi, kurse përditësimi, dhe dhënien e detyrave duke filluar nga faza e përzgjedhjes së kandidatëve;
- u ofrojmë mundësinë të gjithë punonjësve të shprehin individualitetin dhe krijimtarinë në punën e tyre duke marrë me të mirën nga secili prej tyre. Kjo na jep një shtysë drejt inovacionit dhe mundëson dhënien e një kontributi thelbësor në rritjen e Grupit;
- kërkojmë përsosmëri tek rezultate tona në lidhje me sasinë dhe cilësinë, nëpërmjet veprimeve tregtare dhe politikave të buxhetit të cilat janë pjesë e objektivave, planifikohen dhe monitorohen në përputhje me parimet etike të këtij Kodi. Ne respektojmë profesionalizmin dhe dinjitetin e të gjithë punonjësve tanë, si dhe veçoritë e kontekstit ku ata punojnë;

- kushtojmë vëmendjen maksimale përcaktimit të objektivave tona duke lehtësuar kuptimin dhe ndarjen e tyre me qëllim promovimin e sjelljeve korrekte dhe transparente në marrëdhënie me klientët;
- krijojmë sisteme objektive dhe transparente të incentivave të cilat parashikojnë objektiva të mundshme dhe të arritshme;
- lehtësojmë punën duke thjeshtëzuar produktet, procedurat dhe format e komunikimit, si dhe garantojmë shëndetin dhe sigurinë e tyre duke marrë masa gjithnjë e më efikase;
- promovojmë politika që lehtësojnë jetën personale dhe profesionale të të gjithë punonjësve tanë duke mbështetur forma fleksibiliteti dhe duke ndërmarrë iniciativa për balancimin e angazhimeve në punë me nevojat private, të vetëdijshëm që ky ekuilibër është thelbësor për mirëqenien e secilit punonjës;
- vlerësojmë performancën dhe ecurinë e punonjësve që kanë pozita përgjegjësie duke vlerësuar respektimin e parimeve etike në lidhje me marrëdhëniet me punonjësit.

Vlerësim dhe motivim

Në kuadrin e qëllimit tonë për të aplikuar drejtësi, barazi dhe meritë për vlerësimin, shpërblimet, motivimin dhe zhvillimin e karrierës së punonjësve tanë, ne:

- pranojmë që tërësia e marrëdhënieve, aftësive organizative dhe teknike të çdo punonjësi përbën burimin tonë kryesor strategjik, të cilin jemi të angazhuar ta mbrojmë vlerësojmë si faktor kryesor për ruajtjen e avantazheve konkurruese të qëndrueshme;
- përdorim sisteme vlerësimi për sjelljet, kompetencat, dijet dhe potencialet e punonjësve tanë sipas kriterit të transparencës, vlerësimit të meritave dhe respektimit të diversitetit, në mënyrë që të përforcojmë motivimin dhe të japim shpërblime të drejta për të inkurajuar arritjen e rezultateve të shkëlqyera;
- zhvillojmë programe trajnimi që kanë në fokus nevojat individuale me bindjen se dëgjimi i nevojave të shprehura nga punonjësit tanë është shumë i rëndësishëm në hartimin e proceseve të trajnimit;
- i ofrojmë çdo individ kushtet për të interpretuar sa më mirë rolin e tij, për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të tyre, për të zhvilluar kapacitetet e tyre për punën në grup dhe për të kontribuar në arritjen e objektivave të kompanisë;

- promovojmë pjesëmarrjen e përgjegjshme e punonjësve, duke i mbështetur gjithmonë edhe gjatë mungesave të gjata; dhe kërkojmë që ata të zbatojnë vetë vazhdimisht që të ndihen të përfshirë në procesin e rritjes së grupit, përmes të cilit ata mund të arrijnë gjithashtu rritjen e tyre profesionale;
- i kërkojmë punonjësve tanë të bashkëpunojnë për përdorimin e përgjegjshëm të të gjitha burimeve që nevojiten për përmbushjen dhe realizimin e detyrave.

Dëgjim dhe dialog

Duke besuar se dëgjimi dhe dialogu përbëjnë themelin e marrëdhënieve që krijojnë besim, ne:

- promovojmë rolin strategjik të komunikimit të brendshëm për tu mundësuar individëve një pjesëmarrje më të ndërgjegjësuar në jetën e korporatës;
- bazojmë komunikimin në kriteret e korrektësisë, plotësisë, thjeshtësisë dhe transparencës;
- zhvillojmë instrumente për shkëmbimin e informacionit dhe nxitim diskutimin dhe ndarjen e përvojave dhe eksperiencave të cilat gjithashtu mbështesin krahasimet dhe integrimin midis entiteteve të ndryshme territoriale të Grupit;
- angazhohemi që të zhvillojmë, tek punonjësit me detyra përgjegjësie, një ndjeshmëri dhe perceptim të posaçëm për identifikimin e nevojave të punonjësve, duke u mësuar të vlerësojnë sugjerimet e tyre dhe mendimin ndryshe si mundësi për përmirësimin dhe rritjen e korporatës.

Kohezion

Kohezioni është karakteristika dalluese e një komuniteti personash që punojnë mirë së bashku dhe janë krenar që janë pjesë e një korporate të madhe.

Për të nxitur dhe forcuar frymën e kohezionit tek të gjithë punonjësit, mbi bazën e një identiteti të fortë dhe të përbashkët të kompanisë, ne:

- shpjegojmë dhe shpërndajmë vlerat tona, duke verifikuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e tyre, në mënyrë që të gjithë punonjësit të identifikohen me këto vlera;

- informojmë të gjithë punonjësit në lidhje me strategjitë dhe objektivat e bankës dhe të Grupit, me qëllim ndarjen e komponentëve që karakterizojnë identitetin tonë;
- kultivojmë tek personat me funksione përgjegjësie aftësinë për të vepruar si drejtues dhe pikë referimi, duke kryer veprime që janë në përputhje me parimet etike të korporatës;
- zbatojmë politika menaxhimi dhe shpërblimi që njohin dhe vlerësojnë kontributin individual dhe kontributin në grup në arritjen e objektivave;
- parashikojmë forma bashkëpunësuese në sukseset dhe arritjet e kompanisë, edhe në nivel ekonomik;
- promovojmë iniciativa për të ndërtuar një solidaritet në mbështetje të kolegëve që janë në vështirësi dhe në ndjekje të objektivave me rëndësi sociale.

Parimet e sjelljes në marrëdhënie me furnitorët

Dëgjim dhe dialog

Ne besojmë që një sjellje e karakterizuar nga dëgjimi dhe ndarja e ideve me furnitorët tanë nxit dhe mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve, i forcon dhe gjeneron vlerë reciproke nëpërmjet:

- qëndrimeve të mbështetura në besim që përfshin furnitorët në një rol aktiv dhe i shtyn ata të raportojnë menjëherë problemet që kërkojnë identifikimin e një zgjidhjeje të përbashkët;
- matjes së nivelit të kënaqësisë të furnitorëve tanë dhe përcaktimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim, veçanërisht në lidhje me transparencën, komunikimin dhe respektimin e kushteve të pagesës.

Transparencë

Ne besojmë që një qëndrim i qartë dhe transparent kontribuon në ruajtjen e marrëdhënieve të mira me furnitorët. Ne jemi të bindur që integriteti është një kusht themelor për këto marrëdhënie dhe në këtë kuadër:

- ne i zgjedhim furnitorët tanë në bazë të kritereve të qarta dhe të dokumentuara, nëpërmjet një procedure objektive dhe transparente;

- ne respektojmë me korrektësi politikat e kompanisë sipas të cilave marrëdhëniet bazohen në ndershmëri maksimale, veçanërisht administrimi dhe lidhja e kontratave dhe marrëveshjes, duke shmangur situatat e konfliktit të interesit, edhe ato potenciale;
- në rastin e veçantë të konsulencave profesionale, vendimet tona bazohen në kriteret profesionale dhe kompetence, duke shmangur konfliktin e interesit, edhe ato potenciale;
- ne publikojmë politikat tona mbi marrëdhëniet me furnitorët;
- ne kërkojmë marrëveshje tregtare me furnitorë që demonstrojnë ndjeshmërinë e tyre ndaj çështjeve që lidhen me përgjegjësinë e korporatës dhe sociale.

Barazi

Duke qenë se besojmë se një bankë e madhe duhet të jetë e aftë për të administruar me përgjegjësi pozicionin e forcës kontraktuale që ajo zotëron, ne:

- garantojnë mundësi të barabarta për përzgjedhjen e furnitorëve dhe partnerëve tregtare, duke vlerësuar aftësinë dhe kapacitetin e tyre në lidhje me madhësinë dhe nevojat e kompanisë sonë dhe mbështesim krijimin e partneriteteve me kompanitë të cilat janë furnitorët dhe klientët tanë;
- angazhohemi që kontratat që lidhim me furnitorët tanë të bazohen në paanësi dhe drejtësi, veçanërisht në lidhje me kushtet e pagesës dhe respektimin e detyrimeve administrative;

Parimet e sjelljes ndaj mjedisit

Dëgjim dhe dialog

Mbrojtja e mjedisit është një nga dimensionet kryesore të përgjegjshmërisë tonë.

Një nga fushat e politikës sonë të përgjegjshme sociale është mos-shpërdorimi i burimeve dhe angazhimi ynë për t'i kushtuar vëmendje pasojave mjedisore të vendimeve tona. Ne besojmë se një Grup i madh bankar si Intesa Sanpaolo ka ndikim të jashtëzakonshëm në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore, veçanërisht në kontekstin social dhe mjedisor, ku zhvillon aktivitetin, në planin afat-mesëm dhe afat-gjatë. Ky ndikim i atribuohet konsumit të burimeve, emetimit dhe mbetjeve që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e biznesit (ndikim të

drejtpërdrejtë), si dhe me aktivitete dhe sjellje të cilat biznesi nuk i kontrollon drejtpërdrejt, por që kryhen nga palë të treta, p.sh. klientët dhe furnitorët, me të cilët bashkëveprojmë (ndikimi indirekt).

Në këtë kuadër, ne:

- garantojmë respektimin e plotë të kuadrit ligjor në lidhje me mjedisin;
- kërkojmë vazhdimisht zgjidhje të reja dhe efikase për mjedisin; edhe nëpërmjet ofrimit të produkteve dhe shërbimeve specifike klientëve dhe zgjidhjeve për furnitorët tanë;
- angazhohemi të përhapim praktikat më të mira përsa i përket përgjegjësisë mjedisore, nëpërmjet zbatimit të parimeve ndërkombëtare, si p.sh. Deklarata UNEP, Global Compact i Kombeve të Bashkuara dhe Parimet e Ekuatorit, të cilat i zbatojmë;
- jemi të hapur për dialog dhe shkëmbim eksperience me të gjithë ata që përfaqësojnë "zërin" e mjedisit;
- jemi përgjegjës dhe publikojmë nëpërmjet të gjitha kanaleve statistikave tona në lidhje me mjedisin.

Përdorim i përgjegjshëm dhe efektiv i burimeve

- ne ndjekim një konsum të vetëdijshëm të burimeve të nevojshme që duhen për kryerjen e aktivitetit tonë, duke implementuar sistemin për menaxhimin mjedisor dhe përmirësojmë në mënyrë aktive edhe nëpërmjet implementimit të një sistemi për administrimin mjedisor dhe duke përmirësuar në mënyrë aktive efikasitetin e energjisë në aktivitetet tona;
- nëpërmjet monitorimit të të dhënave për mjedisin dhe sensibilizimit të punonjësve që punojnë në bankë, synojmë përmirësimin e vazhdueshëm të sjelljes tonë ndaj mjedisit.

Përgjegjësi mjedisore dhe sociale në rrjetin e furnizimit

- përgjegjësia jonë ndaj mjedisit dhe shoqërisë, shtrihet në të gjithë rrjetin e furnizimit dhe prandaj ne kujdesemi që të orientojmë politikave të furnitorëve tanë drejt mbrojtjes së mjedisit dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe punonjësve;
- ne vlerësojmë furnitorët, të cilët bazojnë aktivitetin e tyre në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe qëndrueshmërisë sociale dhe që marrin masa

dhe përdorin mjetet e nevojshme për të minimizuar impaktet negative të shkaktuar nga aktiviteti i tyre;

- ne jemi të angazhuar që t'i sensibilizojmë furnitorët tanë drejt një sjelljeje të përgjegjshme, që mbështet ndërgjegjësimin ndaj rreziqeve mjedisore, sociale dhe etike që burojnë nga aktivitetet e tyre.

Parimet e sjelljes në marrëdhënie me komunitetin

Dialogu me shoqatat përfaqësuese të partnerëve tanë

Ne mendojmë që dialogu me shoqatat ka një rëndësi strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit tonë të biznesit. Gjithashtu:

- ne dëgjojmë dhe vlerësojmë mendimet e shprehura rreth aktivitetit tone nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile;
- ne kemi krijuar një kanal komunikimi me shoqatat që përfaqësojnë interesat e partnerëve tanë, me objektivin për të bashkëpunuar në funksion të respektimit të interesave reciproke dhe parandalimit të situatave të mundshme të konfliktit;
- ne informojmë shoqatat që konsiderojmë si më përfaqësuesit e grupeve tona të interesit dhe i përfshijmë në mënyrë aktive në çështje që kanë ndikim të veçantë tek grupet tona të interesit.

Mbështetje për organizatat jo-fitimpruese

Duke njohur rolin e organizatave jofitimprurëse në promovimin e zhvillimit të drejtë dhe koheziv të shoqërisë, ne:

- mbështesim kompanitë e përfshira në aktivitete jofitimprurëse dhe sociale dhe zhvillojmë partneritete për të realizuar projekte nga të cilat përfiton komuniteti;
- promovojmë krijimin e një rrjeti të shoqërive sociale për të ndërmarrë iniciativa në favor të shtresave sociale të nevojë;
- krijojmë dhe/ose marrim pjesë në entitete jofitimprurëse, si fondacione dhe konsorciume, qëllimi i të cilave është shërbimi social dhe komunitar;
- mbështesim programet shtesë për mirëqenien.

Përgjegjësi ndaj komunitetit global

Të vetëdijshëm për faktin se balanca ekonomike, mjedisore dhe sociale në mbarë botën varet nga integrimi i faktorëve lokal, ne përpiqemi të ndikojmë në skenarin botëror duke:

- vlerësuar maksimalisht çështjen e zhvillimit të qëndrueshëm sa herë që kemi mundësi të marrim pjesë në procese që përcaktojnë skenarët makroekonomik;
- orientuar politikat e klientëve tanë korporatë dhe duke i mbështetur ata në proceset e ndërkombëtarizimit kur ata ushtrojnë aaktivitetin e tyre në vende me standarde me të ulëta të mbrojtjes sociale-mjedisore;
- përkrahur nismat për solidaritet ndërkombëtar.

Mbështetje ndaj komuniteteve

Ne njohim nevojat, jo vetëm materiale, të komunitetit dhe i mbështesim edhe nëpërmjet granteve dhe sponsorizimeve:

- në zgjedhjen e sektorëve të ndërhyrjes ne u kushtojmë vëmendje të veçantë respektimit të vlerave tona thelbësore, meritës së iniciativave që na propozohen dhe rëndësisë së nevojave sociale që do të plotësohen;
- duke vepruar sipas procedurave transparente dhe të përgjegjshme nëpërmjet procedurave që evitojnë çdo konflikt të mundshëm interesi në rang personal ose korporatë;
- duke bërë të mundur që sponsorizimet të mos influencohen nga interesat komerciale;
- duke vlerësuar dhe mbrojtur trashëgiminë tonë historike, artistike dhe kulturore edhe për arsye të realizimit të interesit publik.

Marrëdhëniet me institucionet

Marrëdhëniet tona institucionale me shtetin, agjencitë përkatëse dhe organizmat ndërkombëtare kanë si qëllim ekskluziv format e komunikimit për vlerësimin e përfshirjes në aktivitetet legjislativ dhe administrative në lidhje me Intesa Sanpaolo Bank Albania. Ne u përgjigjemi kërkesave informale dhe inspektimeve

të sindikatave (pyetje, investigime, etj.) dhe, në çdo rast specifikojmë pozicionin tonë për çështje të rëndësishme, ne:

- vendosim kanale komunikimi të dedikuara dhe të autorizuara me të gjithë pikat e kontaktit institucional në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal;
- përfaqësojmë interesat tona në mënyrë transparente;
- përshtatim modele specifike organizimi për parandalimin e krimeve ndaj Administratës Publike, në mbrojtje të interesave të shoqërisë dhe të gjithë grupeve të interesit;
- kontribuojmë në mënyrë aktive për iniciativat e ndërmarra nga shoqatat dhe organizatat e biznesit që synojnë rritjen, stabilitetin dhe korrektësinë e sistemit bankar dhe financiar.

ZBATIM DHE QEVERISJE

Mekanizmat për zbatim, përhapjen e brendshme dhe qeverisjen

Mekanizmat për zbatimin, shpërndarjen e brendshme dhe qeverisjen e përshkruar më poshtë kanë si qëllim arritjen e objektivave të mëposhtme:

- integrimi i strategjive, politikave dhe procedurave të kompanisë me parimet dhe vlerat etike përmes përhapjes dhe shpërndarjes së përmbajtjes së saj;
- monitorimi i njohurive dhe ndërgjegjësimi për përmbajtjen e tij.

Implementimi i Kodit të Etikës

Kodi i Etikës dhe çdo modifikim i tij në të ardhmen do të miratohet nga Këshilli Drejtues i Kompanisë Mëmë dhe paraqitet në vëmendje të organeve kompetente të kompanive të Grupit për hapat përkatëse.

Zyra e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës është përgjegjëse për përditësimin dhe monitorimin e njohurive të Kodit.

Përhapja e brendshme

Procedurat për publikimin, pjesëmarrjen dhe përfshirjen

Kodi i Etikës publikohet në faqen e internetit ku mund të aksesohet nga konsumatorët dhe palët e interesuara; ai është gjithashtu i vlefshëm në një seksion të rrjetit të brendshëm të kompanisë.

Një kopje e Kodit i dorëzohet çdo drejtori, punonjësi ose bashkëpunëtori të jashtëm në momentin e emërimit, punësimit ose fillimit të marrëdhënies së punës.

Vlerat dhe parimet që Grupi Intesa Sanpaolo ka si qëllim të afirmojë nëpërmjet Kodit të Etikës do të përcillen përmes aktiviteteve trajnuese që synojnë arritjen e konsensusit mbi përmbajtjen e tij dhe sigurimin e instrumenteve për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë rreth mekanizmave dhe procedurave për kthimin e parimeve etike në sjellje për t'u zbatuar materialisht në aktivitetet e përditshme.

Në mënyrë me specifike, kurset e trajnimit do të krijohen me përmbajtje të përshtatshme sipas rolit të secilit pjesëmarrës dhe do të zhvillohen sipas një procesi që do të sjellë trajnimin profesional të punonjësve dhe do të nxisë rritjen personale.

Gjithashtu, në lidhje me nevojat e veçanta që kanë të bëjnë me çështje sensitive të identifikuar nga grupet e interesit, Përgjegjësia Sociale e Korporatës përfshihet në hartimin dhe planifikimin e nismave të trajnimit dhe fushatave

informuese. Kultura dhe vlerat e Kodit të Etikës do të implementohen dhe përhapen edhe përmes të gjitha kanaleve të komunikimit të brendshëm.

Qeverisja e Kodit të Etikës

Për të siguruar zbatimin me të gjerë të Kodit të Etikës, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. merr përsipër të hartojë dhe zbatojë politikat përkatëse për secilën fushë të veprimtarisë me ndikim të lartë etik dhe reputacional.

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA sh.a. ka gjithashtu një Kod të brendshëm të Sjelljes që, në përputhje me parimet etike dhe vlerat e këtij Kodi, përcakton standardet thelbësore të sjelljes për drejtorët, punonjësit dhe konsulentët në zbatimin dhe mbrojtjen e vlerave të Kodit të Etikës.

Modeli nga i cili frymëzohet Grupi Intesa Sanpaolo bazohet në vetë-përgjegjësinë e departamenteve që ndjekin dhe mbrojnë vlerën reputacionale të një sjellje sociale të përgjegjshme.

Çdo departament i bankës zhvillon veprimet dhe aktivitetet e tij duke u frymëzuar nga parimet dhe vlerat e Kodit të Etikës. Për rrjedhojë, çdo departament brenda sferës së vet të ndikimit, ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë, për përcaktimin dhe formalizimin e objektivave, si dhe planin pasues të veprimeve, masave dhe projekteve, në mënyrë që ti japë një kuptim të prekshëm Parimeve të Sjelljes që diktojnë sjelljen e Bankës në të gjitha marrëdhëniet e saj, madje edhe në një logjikë shumëpalëshe.

Në lidhje me parimin e përgjegjësisë vetjake, drejtuesit e Divizioneve / Zyrave duhet të emërojnë delegatët e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR). Ata do të veprojnë brenda departamentit dhe do të bashkëpunojnë midis departamenteve. Ata gjithashtu do të bashkëpunojnë me Përgjegjësinë Sociale të Korporatës së Kompanisë Mëmë, duke identifikuar objektivat e përgjegjësisë sociale brenda departamentit të tyre, duke menaxhuar, monitoruar, dhe duke raportuar në mënyrë periodike mbi progresin e projekteve dhe duke ruajtur marrëdhëniet me grupet e interesit.

Objektivat e lartpërmendura deklarohen dhe monitorohen si pjesë e procesit të menaxhimit që rregullon Raportin e Qëndrueshmërisë.

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

- Nga njëra anë, monitoron efektivitetin e përhapjes dhe informimit nëpërmjet mjeteve të identifikuar, duke filluar nga vlerësimet e brendshme që kanë në fokus matjen e njohurive dhe ndërgjegjësimit, duke evidentuar fushat e dobësisë dhe ndërhyrjet e mundshme; nga ana tjetër, në rastet e fushave me sensitivitet etik dhe reputacional siguron dhe shpërndan politikat dhe udhëzimet e kompanisë;

- mbështet dhe këshillon departamentet brenda kompanisë;
- në bashkëpunim me funksionet përgjegjëse identifikon dhe raporton tregues të veçantë për të vlerësuar nivelin e arritjes së objektivave sociale dhe mjedisore në krahasim me impenjimet e marra;
- bashkëpunon me zyrat e tjera të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Organizimit në zhvillimin dhe përhapjen e kulturës dhe vlerave që janë përcaktuar në Kodin e Etikës;
- monitoron, me mbështetjen e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm, përputhshmërinë me parimet dhe vlerat e Kodit të Etikes, duke raportuar në baza gjashtëmujore në Komitetin e Kontrollit mbi rastet e mosrespektimit të Kodit të Etikës;
- propozon ndryshimet e duhura në mënyrë që Kodi të jetë konsistent me situatën aktuale të kompanisë.

Veprimet në rastet e mosrespektimit të Kodit të Etikës

Në rastet e mosrespektimit të këtij Kodi, Grupi Intesa Sanpaolo do të marrë masat e duhura bazuar në një qasje konstruktive – për raste të ndryshme nga sjelljet mashtruese ose veprimet e kryera në kundërshtim me ligjet, kontratat ose rregulloret specifike - edhe përmes programeve të trajnimit për përforcuar ndjeshmërinë dhe vëmendjen e individëve në lidhje me respektimin e vlerave dhe parimeve të deklaruara në këtë Kod.

Raportimi i rasteve të mosrespektimit të Kodit të Etikës

Raportimi i rasteve të mosrespektimit të këtij Kodi duhet të dërgohen me email në adresën codeOfEthics@intesasanpaolobank.al. Grupi Intesa Sanpaolo garanton që çdo person që raporton në mirëbesim rastet e mosrespektimit të Kodit të Etikës, do të mbrohet nga çdo formë hakmarrjeje, diskriminimi ose penalizimi dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit maksimal, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me ligj.